

K O S O V O



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

THIRRJE PËR APLIKIM PËR REKRUTIMIN E CHAPERONE-VE

PRISHTINË, 30.10.2025

KosADA duke u bazuar në nevojat operacionale për realizimin e testeve për kontrollë të dopingut në territorin e Republikës së Kosovës shpall thirrje publike për rekrutimin e bashkëpunëtorëve të rinj në rolin e Chaperone-ve (shoqërues të sportistëve gjatë procesit të testimit për kontrollë të dopingut).

Chaperone është një person i trajnuar dhe i autorizuar nga KosADA për të kryer detyra specifike gjatë misionëve të testimit për kontrollë të dopingut, duke përfshirë njoftimin e sportistit për përzgjedhjen në testim, shoqërimin dhe mbikëqyrjen e tij/saj deri në mbërritjen në stacionin e kontrollit të dopingut dhe, në disa raste, dëshmimin e dhënies së mostrës.

Ky rol është thelbësor për garantimin e integritetit dhe konfidencialitetit të procesit të testimit për kontrollë të dopingut, në përputhje me Ligjin për Antidopingun, Rregullat Kombëtare Antidoping dhe Standardet Ndërkombëtare të WADA-s.

- **Numri i kandidatëve që do të përzgjidhen**

20 persona (nga të dy gjinitë)

- **Kriteret e aplikimit**

Kandidatët duhet:

Të jenë qytetarë të Republikës së Kosovës, mbi 18 vjeç në ditën e mbylljes së thirrjes;

Të kenë aftësi të mira komunikimi, përgjegjësi të lartë dhe integritet etik;

Të jenë fizikisht aktivë dhe të aftë për ta ndjekur sportistin gjatë gjithë procesit të shoqërimit;

Preferohet që të jenë studentë ose të diplomuar në shkenca mjekësore, shkenca sportive, ose fusha të ngjashme;

Të jenë të gatshëm për angazhim me orar fleksibil gjatë garave dhe misionëve të testimit jashtë garave brenda territorit të Kosovës;

Të mos kenë asnjë konflikt interesi me sportistë, federata apo organizata sportive;

Të demonstrojnë sjellje profesionale dhe respekt të lartë për konfidencialitetin e procesit.

- Trajnimi dhe angazhimi:

Nga aplikimet e pranuar do të përzgjidhen 20 kandidatë për pjesëmarrje në një workshop njëditor trajnues që do të mbahet më 15 Nëntor 2025 në Prishtinë. Kandidatët që e përfundojnë me sukses trajnimin do të certifikohen nga KosADA dhe do të përfshihen në listën aktive të Chaperone-ve, për t'u angazhuar sipas nevojave në misionet e testimit brenda dhe jashtë garave sportive.

- **Afati dhe mënyra e aplikimit**

Thirrja mbetet e hapur për 10 ditë, nga 30 Tetor deri më 8 Nëntor 2025.

- **Kandidatët duhet të dërgojnë**

CV-në e tyre, dhe një letër të shkurtër motivimi (deri në 1 faqe) në adresën elektronike: info@kosada.org me subjektin: Aplikim për Chaperone – Emri dhe Mbiemri

Aplikacionet e paplota ose të dorëzuara pas datës 8 Nëntor 2025 nuk do të merren në shqyrtim.